

Bashkia: KURBIN

Kryetar: ARTUR BARDHI

Fusha: INFRASTRUKTURË DHE SHËRBIME PUBLIKE

Premtime:

1. Do të ristrukturohet Unaza e Kampit, duke përfshirë ujësjellës, sistemim, asfaltim dhe ndriçim
2. Do të kryhet sistemimi dhe asfaltimi i rrugës së Cakonve deri tek lagjja e Bonifikimit, parashikohet të kryhen punimet për 2018-ën
3. Do të kryhet mirëmbajta e të gjithë rrjetit të rrugëve të zonës rurale, prej 40 km
4. Do të kryhet sistemimi dhe asfaltimi i rrugës nga karburant Laska - Ura C. Voli
5. Do të kryhet rikonstruksion dhe zgjerim i rrjetit të ujësjellësit në lagjet e qyteteve për rritjen e efektivitetit të tij
6. Do të ndërtohet godina e re e Bashkisë Kurbin për afrimin e shërbimit më afër komunitetit
7. Do të kryhet rehabilitimi i fasadave të godinave të komplet njësisë së re të qendrës urbane
8. Do të kryhet sistemimi dhe asfaltimi i rrugës Ish Reparti i Tankeve- punimet parashikohen të kryhen brenda 2016-ës
9. Do të kryhet sistemimi dhe asfaltimi i rrugës nga Ura C. Voli - Alk
10. Do të kryhet rehabilitimi i gjithë bllokut të pallateve parafabrikat, në lagjen numër 3
11. Do të zgjidhet problemi i furnizimit me ujë në Delbnisht
12. Do të zgjidhet problemi i furnizimit me ujë për në Zheje
13. Do të zgjidhet problemi i furnizimit me ujë në Sanxhak
14. Do të ristrukturohet sistemi i blloqeve të banimit në lagjen 1 dhe 2
15. Do të kryhet sistemimi, asfaltimi dhe ndriçimi i rrugës Sanxhak - Superstradë me gjatësi 3.4 km
16. Do të kryhet sistemimi dhe asfaltimi i rrugës së Varrezave Sanxhak
17. Do të kryhet asfaltimi dhe sistemimi i rrugëve e rrugicave si dhe zëvendësimi i infrastrukturës nëntokësore të amortizuar, në lagjen 1 dhe 2
18. Do të kryhet sistemim dhe asfaltim i rrugës Mal Bardhë deri tek Kisha, punimet parashikohen të kryhen brenda 2015-ës
19. Do të rikonstruktohet rrjeti i shpërndarjes, të ujësjellësit nga Hekurudha Sanxhak deri tek Kotecët e Fermës
20. Do të kryhet sistemim i pjesshëm i Përroit Laç, pjesa e mbetur parashikohet të kryhet në vitin 2016
21. Do të kryhet sistemimi dhe asfaltimi i rrugës Stacioni i Trenit Laç deri në Uzina e Superfosfatit- punimet parashikohen të kryhen brenda 2016-ës
22. Do të rikonstruktohen rrugët automobilistike, në Gjorm
23. Do të rikonstruktohet rrjeti shpërndarës i ujësjellësit në Zhejë
24. Do të rikonstruktohet rrjeti shpërndarës i ujësjellësit nga Fabrika e vajit në Fushë Gjorm

25. Do të kryhet asfaltimi i rrugës së Fushë Milotit
26. Do të kryhet asfaltimi i rrugës në Laskaj
27. Do të kryhet asfaltimi i rrugës që lidh Mal Bardhin Fushë me rrugën nacionale
28. Do të ndërtohet Ura në rrugën e Gallatës në Skuraj, punimet parashikohen të kryhen brenda 2015-ës
29. Do të kryhet sistemimi dhe asfaltimi i rrugës Skuraj - Gallatë, plan afatgjatë, afërsisht parashikohet për periudhën 2017 - 2018
30. Do të kryhet sistemimi dhe asfaltimi nga Teqja Shullaz deri në Fushë Shullaz- punimet parashikohen të kryhen brenda 2017-2018
31. Do të rindërtohet/riorganizohet me standarte bashkëkohore Pazari i Milotit, një burim të ardhurash për banorët dhe vlerë e traditë e gjithë Kurbinit

Fusha: ARSIM/KULTURË/SPORT

Premtime:

1. Do të krijohen terrene sportive dhe ambiente argëtuese për komunitetin në territorin e bashkisë
2. Do të kryhet rikostruksion i ambienteve sportive të gjithë shkollave, palestra dhe fusha sportive në territorin e bashkisë
3. Do të kryhet rrethimi i ambienteve të shkollave të të gjithë Rrethit
4. Do të rikonstruktohet shkolla e vjetër Sanxhak
5. Do të ndërtohet një kopësht fëmijësh bashkohor, në lagjen 1 dhe 2
6. Do të rikonstruktohet ujësjellësi i shkollës Sanxhak, brenda muajit Qershor
7. Do të rikonstruktohet shkolla nr. 3 Laç
8. Do të rikonstruktohet shtesa e shkollës së Mesme, Laç
9. Do të ndërtohet shkolla e Mesme në Mamurras- parashikohet të përfundojë në 2016-ën
10. Do të kryhet rikostruksion i klasave të shkollës së Gallatës

Fusha: MJEDIS/TURIZËM

Premtime:

1. Do të zhvillohet turizimi fetar, malor, bregdetar dhe historik
2. Do të kryhet shtimi dhe rehabilitimi i sipërfaqeve të gjelbërta në Laç
3. Do të rikthehet shfrytëzimi i plazhit të Patokut

Fusha: BUJQËSI

Premtime:

1. Do të mundësohet, brenda një vit, pastrimi dhe vënia në efikasitet të plotë të kanaleve të kullimit, për të përballuar përmytjet dhe kullimet e tokës në territorin e bashkisë
2. Do të krijohet një Qendër e Grumbullimit të prodhimeve bujqësore në afërsi të autostradës Tiranë - Shkodër
3. Brenda vitit të parë do bëhet e mundur vënia në efikasitet të kanaleve të para dhe të dyta të vaditjes, ndërsa gjatë vitit të dytë kanalet e treta dhe të katërta

4. Do të bëhen investime që fushat në Adriatik mos mbeten të djerra e të përmytura, si dhe do të kthehen në furnizuesit kryesor me produkte bujqësore të njësisë
5. Do të bëhen investime që fushat në Fushë Kuqe mos mbeten të djerra e të përmytura, si dhe do të kthehen në furnizuesit kryesor me produkte bujqësore të njësisë
6. Do të bëhen investime që fushat në Gurëz mos mbeten të djerra e të përmytura, si dhe do të kthehen në furnizuesit kryesor me produkte bujqësore të njësisë

Fusha: TRANSPARENCA

Premtime:

1. Do të forcohet bashkëpunimi i Bashkisë me komunitetin dhe do nxitet partneriteti i sektorit privat me atë publik
2. Do të kryhet këshillimi, takimi publik me të gjithë grupet e interesit
3. Do të organizohen takime dhe konsulta publike para çdo vendimarrje që prek drejtpërdrejt apo tërthorazi grupet e interesit dhe do bëhet një përmbledhje e të gjithë vërejtjeve apo propozimeve të cilat më tej do pasqyrohen në vendimet përfundimtare

Fusha: SHËRBIMET SOCIALE

Premtime:

Fusha: EKONOMI DHE PUNËSIM

Premtime:

1. Gratë do të përbëjnë 50% të Këshillit Bashkiak
2. Do të bëhet zgjidhja përfundimtare e pronësisë së tokës për banorët e zonës
3. Do të hartohen programe për nxitjen e punësimit
4. Do të hapen kurse të formimit profesional dhe fasonet, nisur dhe nga fakti që ka kërkesa të shumta për këto profesione
5. Për të nxitur punësimin do të përkrahen bizneset fasonet, të industrisë së lehtë dhe të përpunimit, aktivitetet bujqësore dhe blektorale dhe hoteleri - turizëm
6. Do të bëhet i mundur zhvillimin ekonomik lokal i qëndrueshëm duke integruar zhvillimin e biznesit, bujqësisë, turizmit etj, për nxitjen e punësimit, në Fushë Gjorm